



HAL
open science

MBI EKONOMINË POLITIKE TË EROTIZMIT ose Mijëra fjalë në shërbim të heshtjes

Orgest Azizi

► **To cite this version:**

Orgest Azizi. MBI EKONOMINË POLITIKE TË EROTIZMIT ose Mijëra fjalë në shërbim të heshtjes. Georges Bataille, Erotizmi, IDK, 2009. hal-02094591

HAL Id: hal-02094591

<https://hal.science/hal-02094591>

Submitted on 9 Apr 2019

HAL is a multi-disciplinary open access archive for the deposit and dissemination of scientific research documents, whether they are published or not. The documents may come from teaching and research institutions in France or abroad, or from public or private research centers.

L'archive ouverte pluridisciplinaire **HAL**, est destinée au dépôt et à la diffusion de documents scientifiques de niveau recherche, publiés ou non, émanant des établissements d'enseignement et de recherche français ou étrangers, des laboratoires publics ou privés.

MBI EKONOMINË POLITIKE TË EROTIZMIT

ose

Mijëra fjalë në shërbim të heshtjes

*Pour Alice Marquet
qui sait compter, sans jamais calculer*

Projekti i *Erotizmit* (libër i botuar më 1957) shtrihet pothuajse gjatë gjithë aktivitetit intelektual të Batailleit. Tekstet e botuara dhe dorëshkrimet e gjetura pas vdekjes e vërtetojnë këtë. Mes këtyre të fundit, përveç tekstit përfundimtar të botuar, gjenden edhe dy variante të tjera, të papërfunduara por mjaft të gjata të *Erotizmit*, të cilat Bataillei i ka braktisur në udhë e sipër : njëri me titullin *Histori e erotizmit*, dhe tjetri i ashtuquajtur "varianti i 1953-shit". Libri i fundit që boton Bataillei pak para vdekjes, më 1962, *Les larmes d'Eros* ("Lotët e Erosit") është po ashtu një lloj rimarrjeje, më e ngjeshur dhe gjerësisht e ilustruar, e temave dhe momenteve argumentative të *Erotizmit*. Po ashtu, siç tregohet dhe gjatë librit, një pjesë e teksteve që përbëjnë variantin përfundimtar janë ese, parathënie apo konferenca të botuara më parë dhe të ripunuara me rastin e përfshirjes në një libër të strukturuar, deri te kapitulli i fundit "Parathënie e romanit *Madame Edwarda*", roman të cilin Bataille-i e kishte botuar fillimisht me pseudonim më 1941. Po të mbajmë parasysh pra fiksionet erotiko-pornografike, të cilat ai i shkruan qysh nga fillimet e aktivitetit letrar (*Histoire de l'œil* – "Histori e syrit" – 1927) e deri në fund të jetës (*Le Bleu du ciel* – "Kaltërsia e qiellit" – *Ma mère* – "Ime më", i botuar pas vdekjes), *Erotizmi* del si përpjekja e meditar gjatë për të përmbledhur dhe kurorëzuar intuiat themelore intelektuale dhe spirituale të Bataille-it, duke u dhënë një formë sa më teorike që të ishte e mundur. Ky kurorëzim teorik vjen njëkohësisht edhe si pjesa plotësuese e formave të tjera të artikulimit të së njëjtës intuite (apo të të njëjtit obsesion – atij të erotizmit si dukuri e hyjnishtme, si eksperiencë e skajshme e "çastit të kapërcimit, e gulçimit të jashtëzakonshëm të ekstazës që përziën tmerrin me gazmimin¹ ").

¹ Shih G. Bataille, *Histori e syrit*, përkth. shqip nga A. Çani dhe E. Tupja, bot. Zenit, Tiranë 2005, fq. 6.

Por *Erotizmi* është pjesë përbërëse e një projekti ende më të gjerë e të strukturuar ; tematika e tij del si një nga nyjet e një teorie me të përgjithshme që përfshin tërë filozofinë e Batailleit, si një nga faqet e sistemit të tij të shpjegimit të botës, do të mund të thoshim, sikur vetë ai të mos kishte këmbëngulur aq shumë e aq shpesh mbi mangësitë e çdo dëshire të shpjegimit të botës me anë sistemesh, përfshirë mes tyre dhe atë të Hegel-it, aq të admiruar. *Erotizmi* duhej të përfshihej në brenda e një trilogjie, e cila, nën titullin e përgjithshëm *La Part maudite* ("Mbetja e nëmur") paraqitej si më poshtë :

Vëllimi I : *Erotizmi*

Vëllimi II : *La Souveraineté* ("Sovraniteti" – term që ai e përdor jo me kuptimin politik të prerogativave të patjetërsueshme të shteteve apo kombeve në marrëdhëniet ndërkombëtare).

Vëllimi III : *La Part maudite* ("Mbetja e nëmur" – libër i botuar më 1949, në të cilin përfshihet si hyrje edhe një tekst i vitit 1932, *La notion de dépense* : "Koncepti i shpenzimit"). Projekti si i tillë nuk arriti deri në pikën përfundimtare të botimit, nga njëra anë si pasojë e pështjellimit konceptual të Batailleit dhe, nga ana tjetër, si pasojë e vdekjes së tij gjithsesi të parakohshme, në moshën 65 vjeçare. Përpunimi i *La Part maudite* (librit të botuar) i ka kushtuar autorit – siç e pohon vetë në parathënien e librit – mëse 18 vjet punë pothuajse të pandërprerë, gjë që na bën të mendojmë se periudha e zanafillës së projektit është rreth fundit të viteve '20 dhe fillimit të viteve '30. Temat e parashtruara tek *Erotizmi*, pra, janë disa nga boshtet qendrore ku plekset uniteti i vështirë i një meditimi të pjekur gjatë një këmbënguljeje tridhjetëvjeçare. Në këtë pasthënie të shkurtër do të përpiqem t'i afrohem sa më shumë – për ta vënë në pah – unitetit të kësaj ecurie të mendimit ku lidhen paradoksalisht ekonomia, politika dhe erotizmi. Një përpjekje e tillë, e artikuluar kaq shkurtazi, sigurisht që nuk është e lehtë ; ajo do të jetë doemos e mangët dhe e çalë. Pena stepet kur mendojmë se është fjala për atë mendimtar të paklasifikueshëm të cilin M. Foucault e quante shkrimtarin më të madh të shekullit ; të vetmin që M. Durasi pranonte të citonte pa ngurrim si modelin e përgjegjësisë absolute të shkrimit ; atë që M. Blanchot e mbante si udhëzuesin e pareshtur të gjithë mendimit të vet ; së fundi, atë personalitet, për të cilin, në një deklaratë të fortë më 1955, Heidegger-i shprehej se ishte pa dyshim "mendimtari më i mirë që kishte Franca".

Te *La part maudite*, përpjekjet e Batailleit, "qysh prej 18 vjetësh", shkojnë drejt artikulimit të një modeli të ri të Historisë së Gjithësishe, në mënyrë të veçantë përmes ekonomisë dhe etnologjisë. Historia e Gjithësishe (*Histoire Universelle*) është një zhanër trajtuese që ka rregullat, historinë dhe poetikën e vet. Por e gjitha kjo i takon së shkuarës. Zhanri pati shterur nga fundi i shek. XVIII, pikërisht si pasojë e ndarjes dhe veçimit të

disiplinave përbërëse si historia apo ekonomia, e lindjes së etnologjisë si shkencë e mëvetshme, e gramatikës historike, dhe si pasojë e shndërrimit pozitiv të secilës nga këto forma të dijes shkencore. Hegeli është i fundit që e kurorëzon filozofikisht zhanrin, duke vendosur kështu edhe për-sosjen e tij historike (në të dyja kuptimet e fjalës). Duke iu referuar Historisë së Gjithësishtme (lloj ligjërimi të cilit mund të thuhet se i përkasin edhe *Historia e erotizmit* apo *Lotët e Erosit*) Bataillei tregon qartë se synimi i tij nuk është historik por filozofik. Historia e Gjithësishtme, ndërkohë që zhduket si formë racionaliteti nga artikulum i diskursiv i dijes historike në fundin e shek. XVIII, dhe që është më së shpeshti traktat teologjie (apo paraqitje e ndonjë teodiceje), ontologjie, morali apo ekonomie (ose të gjitha këto së bashku), Historia e Gjithësishtme, pra, në kohët moderne, mbijeton vetëm si formë e huazuar e ligjëritimit filozofik. Marxi e parashtron në disa vija të trasha pas (në vijim të dhe kundër) Hegelit ; A. Comte propozon një ndarje tjetër në kuadrin e mendimit të tij pozitivist, (tre stadet e njerëzimit) ; Nietzscheja në njëfarë mënyre nën formën e një "gjenealogjie të moralit", etj. Në formulimin e tij Bataillei kryqëzon ndikimin e Hegelit (madje, mund të shtrohet pyetja se sa i mundur do të ishte një konceptim i Historisë së Gjithësishtme pa përfshirë asnjë referencë ndaj Hegelit – me siguri aspak) me rezultatet e shkencave të reja shoqërore – antropologjia, etnologjia, historia e feve – të cilat po njihnin një zhvillim të madh në atë kohë dhe që Bataillei i njihte nga afër. Motori i errët që shërben si shtypa e përhershme e kësaj Historie² do të jetë në këtë rast pikërisht "mbetja e nëmur", fuqia e saj heterogjene ; lënda konkrete e Historisë do të përbëhet për pasojë nga tërësia e teknikave që synojnë të mundësojnë mohimin e çdo efektshmërie shkatërruese të kësaj mbetjeje³. Bataille i kthehet, pra, këtij lloj ligjërimi pas përsosjes hegeliane, në mënyrë arkaike, ose – për ta thënë me një term niçean – në mënyrë inaktuale, duke nuhatur aty një të vërtetë të thellë. Por ndërhyrja e tij synon të provokojë një çarje, më saktë një mosmbyllje thelbësore dhe të pasosur të qarkut hegelian, nëpërmjet parashtrimit të një ontologjie të teprisë dhe të shtojcës, dhe rindërtimit të figurave historike ku mishërohet dinamika e kësaj mbetjeje të nëmur.

Shkycja e sistemit të Hegelit mund të ishte kështu pika e parë dhe qendrore, ideja më thelbësore por edhe e kudogjendur e mendimit të Batailleit. "E para" them për efekte didaktike, sepse mjegullnaja e këtij mendimi shumëformësh është si gjithësia e pamatë e Pascal-it, qendra e të cilit gjendet kudo dhe rrethshkrimi askund. Intuita themelore

² "Shtypa" është një nga kategoritë e domosdoshme të çdo modeli të Historisë së Gjithësishtme. Kështu, për Hegelin është vetpërçarja e ndërgjegjes dhe odiseja e saj mohuese drejt rikthimit të një unitet i ri, më të pasur ; për Marxin është lufta e klasave, për Nietzsche vullneti për fuqi dhe konflikti i forcave aktive dhe reaktive, etj.

³ "Përdorimi që i bëhet kësaj mbetjeje është shkaku i shndërrimit të çdo strukture, domethënë, i gjithë historisë së qytetërimeve". J. Piel në « Hyrjen » e G. Bataille, *La Part maudite*, bot. Minuit, Paris 1967, fq. 19.

"çhegelianizuese" e Batailleit është relativisht e thjeshtë, dhe moderniteti, njësoj si dhe kërkimet më të përparuara të shekullit XX, e lakojnë atë në mënyra të ndryshme. Por zjarri, madje, mund të themi, epshi konceptual dhe ekzistencial me të cilin Bataillei e identifikoi tërësinë e aktivitetit të vet me hulumtimin deri në skutat më të thella të kësaj ideje, e bëjnë atë të jetë ikona më e qëndrueshme e modernitetit përse i përket aspiratave të mendimit gjatë tij : kërkimit të rrugëdaljeve nga hegelianizmi.

Hipoteza, thashë, është relativisht e thjeshtë dhe ja një formulim akoma më i thjeshtuar i saj : në çdo sistem ka gjithmonë një tepri, një mbetje, një shtojcë të patrajtuar dhe të pamenduar (të patrajtueshme dhe të pamendueshme) nga mjetet e brendshme të vetë sistemit. Nga pikëpamja mekanike, kjo mbetje përfaqëson një tepri energjie që tejkalon sistemin dhe që duhet të harxhohet pa dobi, pa fitim, pa qëllim të caktuar dhe pa prodhimtari (ose duhet të konvertohet duke prodhuar një sistem më të ndërlikuar). Nga pikëpamja ekonomike, kemi një shpenzim pa hesap dhe llogari, shpërthimin e një aktiviteti jo rritjeje, jo prodhues, por humbjeje dhe shkatërrimi. Nga pikëpamja racionale do të themi se, nëse çdo sistem është një sistem rregullash dhe arsyesh, vendndodhja e kësaj teprie është jashtë tij ; ajo përbën mbetjen irracionale të papërputhëshme me sistemin, dhunën pa rregulla ; njëherazi forcën e jashtme shkundëse edhe kushtin heterogjen të formimit të tij. Ndërkohë që, nga pikëpamja sociologjike, do të themi se, nëse çdo sistem është sistem raportesh shoqërore dhe rregullash profane, tepria është pjesa e shenjtë apo e hyjnishtme (*sacré*), shtojca e errët *asociale*, magjepsja dhe trysnia shformuese e së cilës ushtrohen mbi tërësinë e korpusit të rregullave shoqërore. Tepria, pra, në varësi të llojit të sistemeve ku analizohet, merr figura të ndryshme : shtojcë energjie, dhunë joracionale, forcë e hyjnishtme asociale apo "mbetje e nëmur". Për shembull, disapak vite më vonë, strukturalizmi përpunoi versionin gjuhësor të kësaj dukurie : nuk ka sisteme (shenjash) të mbyllur dhe të plotë por : a) çdo sistem është sistem diferencash dhe b) mangësia dhe shtojca, ose, për t'u shprehur me termat që filozofi A. Badiou ia huazon matematikës, boshi dhe mbi-numërori janë dy elemente të pashmangshme të çdo sistematizimi. Idetë si ajo e Zotit, e së hyjnishtmes (*le sacré*), e erotizmit, e sakrificës, apo praktikat e shenjtërisë dhe misticizmit, nga njëra anë, dukuritë e dhurëtisë dhe të *potlach*-it, nga ana tjetër, konfigurojnë më së miri shpërhapjen e përsëritur të kësaj strukture aktive, njëherazi parim formues dhe pika e errët e çdo organizimi. Po ashtu, anë të tjera paradoksale të jetës shoqërore si festat, karnavalet, lojërat, luksi, deri te poezia dhe artet e kulluara. Në faqen negative, luftërat, shpërthimet shkatërruese, etj.

Nëse teza është e thjeshtë për t'u formuluar, ideja që ajo përmban dhe rrjedhimet e përpikta të saj nuk janë të lehta, as për t'u menduar pa dredha e as për t'u shprehur pa tradhti.

Përderisa gjuha dhe ligjërimi janë po aq sisteme, ashtu si dhe vërtetimi, rendi i arsyeve etj., si mundemi atëherë të mendojmë dhe të shprehim atë që është përtej fjalëve, shtojcën që mbetet kur gjuha është shuar, atë çka përfaqëson vetë rrezikun e rrënimit të çdo forme gjuhësimi ? Jo më kot çështja e komunikimit dhe e të-qenit-së-bashku (si dhe ajo e komunizmit) kanë qenë përherë pikat qendrore ku përplasej dhe rrihte mendimi i Batailleit. Në këtë pikë, forca e madhe e Bataille-it është se ai vendosi, më me rreptësi se ndoshta kushdo para tij, se çdo bashkësi (apo shoqëri), në kuptimin e vërtetë të fjalës, është të paktën paradoksale, në mos e pamundur, për arsye se : themeli dhe kushti i çdo shoqërie (bashkësie, shoqërizmi, i të-qenit-së-bashku në përgjithësi) përbëhet nga një forcë a-sociale, nga një shtojcë e papërthithshme në gjirin e sistemit, nga një energji qendërikëse që anulon, ose kërcënon, përpjekjet strukturuese të shoqërisë. Vërtetësia e shoqërisë qëndron te mohimi i vetë shoqërisë. Çdo bashkësi, pra, nuk mund të jetë tjetër veçse paradoksale, në distancë të brendshme me veten, e rrëmbyer pafundësisht në një marrëdhënie luhatëse me kushtet dhe themelet e veta, lëvizje që Th. Adorno do ta përcaktojë si "dialektikë negative". Dialektikë që nuk përmbyll, as përmbledh e as përsos, por e lë luhatjen pafundësisht të hapur, duke neutralizuar çdo anë apo rezultat akumulues. Që çdo bashkësi është paradoksale, në mospërputhje të përhershme me vetveten, e ndarë me një boshllëk të pamatur nga vetvetja, do të thotë se politika nuk qëndron te mbushja e boshllëkut, apo te mohimi i tij, duke synuar fiksimin, ngulitjen përfundimtare të bashkësisë (pra fundin e politikës), por te nxjerrja në dukje e tij – e boshllëkut – sa më në qendër të bashkësisë. Politika qëndron te të-bërit-të-dukshme e asaj shtojcë, asaj teprie, që mbetet e pallogaritur (dhe e pallogaritshme) në ndërtimin e bashkësisë, duke parë aty vërtetësinë e errët të saj. Nga M. Blanchot (*la communauté négative* = bashkësia negative), te J.- L. Nancy (*la communauté désœuvrée* = bashkësia në zhveprim), te G. Agambeni (*la communauté-chevienne* = bashkësia-në-ardhje), apo te J. Rancière (*la communauté des égaux* = bashkësia e të barabartëve dhe politika si *mésentente* = mospërputhje/mosmarrëveshje), ky koncept i bashkësisë paradoksale është sot ushqyesi i mendimit filozofik më bashkëkohor mbi politikën.

Çështje, pra, e mundësisë së çdo bashkësie, çështje e komunikimit. Jo vetëm "Kush flet ?" – siç pyeste Beckett –, jo vetëm "Çfarë thotë ?" – siç pyeste Foucault –, por edhe, madje së pari, "Kujt mund t'i drejtohesh ?" është shqetësimi i Batailleit. Intuita, në mos eksperiencia konkrete e kësaj teprie, janë ndoshta të mundshme (Bataillei pohonte se i kishte përjetuar të dyja – aventurën dhe torturën dialektike të këtij përjetimi e pati rrëfyer më 1943 në librin *L'Expérience intérieure* ("Experienca e brendshme"), ese-martire e quan Sartrei, i cili

e përshëndet dhe e komenton gjatë në një artikull me titullin "Ardhja e një mistiku të ri"⁴). Por ama, sa janë të komunikueshme, kjo intuitë dhe kjo eksperiencë ? Si mund të përçohen dhe të ndahen bashkërisht, me anë të gjuhës njerëzore, ideja dhe njohja e asaj çka është njëkohësisht kushti i gjuhës dhe humnera ku ajo shpërbëhet ? A ekziston një eksperiencë e formulueshme e kufijve të skajshëm (pardon për pleonazmën !) dhe cili do të mund të ishte rrëfimi besnik i kësaj *eksperience-në-skaje* ? Rrëfim të cilit Bataille duket se ka marrë përsipër t'i japë të gjitha format e mundshme : tregime dhe fiksione ku përzihen erotizmi dhe misticizmi më i zyrtë, rrëfime autobiografike ku jepen në detaje eksperiencat personale dhe rrebeshet shpirtërore të autorit, shënime leximi dhe komente veprash të shumta, gjuha e të cilave i afrohet më së tepërmi – me sytë sa më guximshëm mbajtur çelur – humnerës së qenies, kërkime të gjata dhe paraqitje të hollësishme të fakteve historike, antropologjike, etj. (art, skulptura, rite, luftëra...), analiza të ngjarjeve ekonomike dhe politike të kohës (fashizmi, Plani Marshall, lufta e ftohtë etj.), teorizime filozofike... Korpusi tekstual i *Erotizmit*, kështu siç paraqitet këtu në variantin përfundimtar, qëndron pak a shumë në udhëkryqin e gjithë këtyre formave të shkrimit, por duke qenë gjithsesi më afër teorizimit dhe eksplorimit të fakteve historike sesa fiksonit apo autobiografisë (por nuk duhet anashkaluar përdorimi ngulmues i vetës së parë gjatë gjithë librit – sidomos te *Hyrja* –, referenca e përsëritur e mistikës, largimi i theksuar ndaj çdo forme të ngushtë dhe ngushtuese të objektivitetit shkencor, deri te parathënia e romanit *Madame Edwarda*).

Kjo vendndodhje në udhëkryq e librit e gjen domosdoshmërinë e vet tek efikasiteti i dyfishtë i konceptit të erotizmit, i cili është pikëtakimi i dy përmasave të dukurisë, asaj personale dhe asaj kolektivo-historike. Në të njëjtën mënyrë, seksualiteti te Foucault-ja është pikëtakimi i dy politikave : njëra, anatomo-politikë, formë e një pushteti që synon disiplinimin e trupave dhe ushtrohet tek individit nëpërmjet teknikave të kontrollit të seksualitetit të secilit (nisur nga fëmijët), dhe tjetra, bio-politikë, që synon normalizimin e popullatave dhe ushtrohet te masat dhe grupet njerëzore nëpërmjet kontrollit dhe medikalizimit të higjienës (seksuale) shoqërore. Në fundin e viteve '20, teksa zbulon përmes etnologëve dhe historianëve të fesë, veçanërisht nga Marcel Maussi, teorinë e dhurëtimit, formë arkaike e këmbimit në shoqëri të cilat e organizojnë prodhimin dhe institucionet e tjera të tyre në varësi të shpenzimit shkatërrues, dhe jo e kundërta, Bataille kupton i ekzaltuar se po ajo tallandi vluese që përjetonte në vetvete pasqyrore edhe ligjin e thellë të dinamikës së botës. Eksperienca e Bataille-it është fillimisht e brendshme, por ajo gjen tek analiza e botës elementet gjegjës që i

⁴ J.P. Sartre, "Un nouveau mystique", në *Critiques littéraires. Situations I*, bot. Gallimard, Paris 1947, fq. 133-175.

flasin për të njëjtën ecuri, për të njëjtin tërbim ; logjika e botës dhe faktet historike tregojnë se sytë e çelur deri në fund, si brenda vetes (ushtrim që Bataille-i e quan "metodë meditimi") ashtu dhe mbi botën, shohin së fundi, në prag të alivanisë, po atë themel të humnershëm, po atë mangësi të tepërt e të paplotësueshme që është vërtetësia e parë dhe e fundit e qenies ; po atë pathemeli të egër që përpiqen të mohojnë (duke mbyllur sytë) fiksionet e formave të stabilizuara (identitete, institucione, besime zyrtare, rregulla, kuptime, gjuhë...). Erotizmi është kështu transhendentali i ri i këtij Kant-i të ethshëm të shek. XX, ku struktura e vërtetësisë së thellë të subjektit barazvlen, falë pajtimit formal, gjykimin objektiv të botës, për t'u shkrirë së bashku në një teori të përgjithshme të qenies. Riaktivizim i papritur i urdhëresës së filozofisë së lashtë (faqja e ashpër e së cilës shpërthen tek eksperiencia e Bataille-it) : "Njeri, njih vetveten !" Erotizmi është pika ku njohja e afekteve të vetvetes nga secili (kushdo, në fakt, mund ta përjetojë eksperiencën njohëse të erotizmit, me kusht që të mos i mbyllë sytë, të mos u sprapset kufijve) përket me njohjen e dinamikës së afekteve dhe forcave simbolizuese që përshkojnë botën. Ekonomia bëhet kështu libidinale (Lyotard-it do t'i kujtohet disa vite më vonë), Marxi takohet me Freud-in, ekonomia politike është njëkohësisht ekonomi psikike e afekteve. Nga kjo pikëpamje, vazhduesit e hareshëm të Batailleit janë Gilles Deleuze dhe Felix Guattari, të cilët tek *Anti-Edipi. Kapitalizëm dhe skizofreni*, përveç shkrirjes ekonomie politike, ekonomie psikike dhe etnologji, ndërmarrin njëkohësisht pa frikë artikullimin e një Historie të Gjithësishtme si Ontologji përshkruese e strategjive dhe drejtimeve rrjedhëse (*lignes de fuite*). Ajo që Bataille e quan erotizëm (i shenjtë) i duhet përafëruar asaj çka paraqesin Deleuze dhe Guattari nën termin skizofreni⁵.

Raporti themelor me qenien që eksperimentohet dhe shpaloet gjatë hulumtimit të seksualitetit është ai i shkeljes, si lëvizje jo-dialektike ku kapërthehen qenia dhe kufijtë e skajshëm. Qenia feks vetëm në kapërthimin me kufijtë, por në skajet e kufirit gjuha rrënohet, subjekti i fjalës thërmohet, i shpronësuar nga zotërimi i gjuhës së vet. Kësisoj, vendosja e seksualitetit si problem themelor i njohjes së qenies (element që i mungoi përjetësisht Heidegger-it) shënon historikisht kalimin nga një filozofi e njeriut punues, tek ajo e qenies gjuhësore. Seksualiteti lidhet kështu me një ekonomi të re politike që, duke kaluar nga pikëshikimi i ngushtë të pikëpamja e përgjithësuar, ajo e tërë universit, nuk bazohet më te

⁵ G. Deleuze dhe F. Guattari, *L'Anti-Édipe. Capitalisme et schizophrénie 1*, dhe *Mille Plateaux. Capitalisme et schizophrénie 2*, bot. Minuit, Paris 1972 dhe 1980. Një shembull, ndër shumë të tjerë : qysh herët, dhe para shumë të tjerëve, lidhur me actekët për të cilët kishte informacione ende të pakta, Bataillei bën dallimin mes "société guerrière" (shoqëri luftarake, më pranë të hyjnishmes dhe sakrificës) dhe "société militaire" (shoqëri ushtarake, profane dhe dogmatike). Të njëjtin model rimarin D&G duke ndërtuar çifitin "machine de guerre" (makinë luftarake, model i rezistencës nomadike, rrjedhëse) dhe "appareil de capture (d'Etat)" (aparati mbërthyes (shtetëror), model i despotizmit sedentar).

rrallësia dhe uria si nevojë e llojit, por te shkelja, dhe pra, te tepria dhe shpenzimi. *Erotizmi* riprodhon në kapitujt e vet këtë lëvizje duke kaluar nga analizat e njeriut punues, teksa ngre, duke punuar, kufij dhe ndalime, te *skandali* sadian i dhunës dhe seksualitetit, për të përfunduar drejt një kritike të ligjëritit filozofik dhe parashtrimit të kërkesës së një gjuhe të pamundur, gjuhës së atij që flet "në shërbim të heshtjes" dhe kundër llafazanëve. "Gjuha e Bataille-it shembet pa reshtur në gjirin e hapësirës ku ngrihet, duke e braktisur të zhveshur, në incerinë e ekstazës, subjektin e dukshëm dhe ngulmues, i cili, ndërsa përpiquej të zotëronte gjuhën tej e tej, e gjen veten të flakur jashtë saj dhe dergjet i kapitur në pluhurin e gjërave që nuk arrin t'i shprehë⁶".

Paradoks, pra, i gjuhës dhe i librit të Batailleit⁷. Treqind faqe për të predikuar heshtjen. Por paradoks për të cilin është mëse i ndërgjegjshëm, dhe ndoshta më shumë se kushdo tjetër. Mirëpo, që nga filozofia greke e deri te filozofia e sotme analitike, paradoksi ka virtytet e veta shpalosëse, për të cilat Bataille është jo më pak i ndërgjegjshëm. Ky paradoks i marrëdhënies së tij me gjuhën është po ai që Bataille vë në dukje në rastin e Sadeit (Pjesa e dytë. Studimet II dhe III). Gjuha që vërshon nga pena e këtij të fundit, teksa alternon përskrimet e imëta të skenave makabre (zhanri dëftues) me fjalimet e stërgjatura filozofike (zhanri argumentues) është një gjuhë e pamundur : apologji e krimit dhe e sovranitetit absolut, gjuhë e xhelatit. Mirëpo xhelati nuk flet dhe sovrani, në parim, është i vetmuar. Krimi është i heshtur, ndërkohë që fjala e Sade-it rrjedh pa mbarim. Njësoj Bataille shkruajti, kokëfortësisht, me ngulm, deri në fund (tekste, komente, konferenca, artikuj, drejtim revistash, refleksione teorike, lutje, autobiografi, fiksione, poema – tekste të shkruara e rishkruara, ripunuara e korrigjuara vazhdimisht), duke qenë një nga shkrimtarët më të rreptë dhe pa kompromise të shekullit. Mes formave përfundimtare të një teksti të botuar (shënime leximi të rimarra si artikuj reviste, të ripunuara si konferencë publike, të korrigjuara për t'u përfshirë si kapitull i një libri...), në masën e gjerë të dorëshkrimeve, shtrihet dukshëm puna e fshehur e një shkrimi të sertë e përgjegjës. Ky mendimtar që synon heshtjen, s'ka çast që të mos flasë apo shkruajë : "Dua të gjej ato fjalë që – në një pikë të dhënë – arrijnë të sjellin heshtjen sovrane dhe të thyejnë rrjedhën e gjuhës së artikuluar". Kjo sepse heshtja nuk është e komunikueshme si e tillë : as si kuptim, as si shembull, as si urdhër – domosdoshmërisht paradoksal – e as si sëmundje ngjitëse. Ai që vetëm hesht çëkziston dhe përmbytet nën llomotitjet e syve që nuk

⁶ M. Foucault, "Préface à la transgression", në *Critique*, n° 195-196, *Hommage à Georges Bataille*, gusht-shtator 1963, fq. 759.

⁷ "Thashë se erotizmi është heshtje, se erotizmi është vetmi" ; "Doja t'ju ngjallja mosbesimin ndaj gjuhës" ; "Kush flet pohon pafuqinë e vet", e të tjera deklarata të Bataille-it në libër, sidomos te *Hyrja*, te Studimet.VI dhe VII, dhe *Mbyllja*, disa nga çastet më të ashpra të kritikës që ai i drejton filozofisë.

duan të çelen. Heshtja kërkon militantizëm. François Wahl, mendimtar i thellë, kritikonte në emër të lakano-strukturalizmit qëndrimin e Batailleit ndaj gjuhës : "ka një paradoks të jashtëzakonshëm te Bataille : aty ku asistojmë në kthim të subjektit, aty gjuha ndalet. Thua se subjekti mund të ngrihet mbi mungesën e gjuhës, pa të, në vend të saj⁸ ". Mirëpo, a është vërtet e pamundur ekzistenca e çdo lloj subjekti të heshtjes sovrane ? Nuk flas për mundësinë për t'u shfaqur, për të mbirë si subjekt në mungesë të çdo lloj gjuhe, por për t'u prodhuar si subjekt përmes ushtrimit të *arsyeshëm* e syçelur të çrregullimit sistematik të gjuhës (të të gjitha shqisave – thoshte Rimbaud-ja), si mbështetje-dhe-vektor i forcës së heshtjes. Subjekti i ndërtuar si besnikëri e heshtjes sovrane s'mund të jetë tjetër veçse strategjik, pra, subjekt veprues që punon për heshtjen. Marrëdhënia me gjuhën bëhet kështu paksa më e pleksur dhe, përtej alternativës së thjeshtë mes fjalës dhe heshtjes, kemi të bëjmë me tri forma (të përdorimit) të gjuhës : a) përdorimi përditshëm që i bën bota, hipokrizia-e-nevojshme-e-qetësisë dhe paqtimit, lënda e fiksioneve simboliko-politike ("fabula e bukur" për të cilën flet Platoni te *Republika*), të cilin Bataille-i e quan përdorim "llafazan", "llomotitje" ; b) gjuha e artikuluar si *Logos*, përmbajtje e parashtrim racional i mendimit : është forma që përqafon nganjëherë Bataille në tekstet teorike, në pajtim me parimin që kërkon të merret seriozisht verbëria e symbyllurve, nënshtrimi i të nënshtruarve, për t'u përballur me forcën që i mban ata kokulur (kështu p.sh. këtu, te Studimi III : "Dua t'i drejtohem njeriut në ankth, atij që sheh te Sade-i vetvetiu vrasësin e mundshëm të së bijës", dhe pak më tutje : "Dua të flas për Sade-in, edhe një herë, vetëm nga pikëpamja e atyre që revoltohen prej tij, dhe duke iu drejtuar atyre"). Ashtu si në pjesët argumentuese xhelatët e Sade-it u paraqesin gjerë e gjatë viktimave arsytet që i bëjnë krimet e tyre racionale dhe në përputhje me natyrën, po ashtu Bataille-i procedon në mënyrë logjike dhe teorike për të na shpënë drejt shpalosjes së origjinës së paarsyeshme të arsyes, dhe arritjes së të pakonceptueshmes si qëllim i çdo kuptimi ; c) së fundi, kemi përdorimin e çrregulluar të gjuhës, atë që, përtej renditjes së paqme dhe harmonike të arsyes, përfshin dhe pasqyron brenda vetes identitetet paradoksale (jetë dhe vdekje, ankth dhe ekstazë, dhimbje dhe hare, etj.) ; atë që bëhet streha e kryqëzimit të të kundërtave, të cilat meditimi syçelur ka arritur t'i përftojë, së bashku, në skajet e qenies ; atë që çliron, përmes kësaj përplasjeje, fuqinë shkatërruese, shpërbërëse, domethënë fuqinë e heshtjes që përmban në vete gjuha. Bataille mundet kështu të vërë re, të ndiejë "heshtjen e Molloit"⁹ . Qëllimi nuk

⁸ F. Wahl, "Nu, ou les impasses d'une sortie radicale", në *Bataille. Actes du colloque de Cerisy*, bot. 10/18, Paris 1969, fq. 235.

⁹ Molloi, personazhi eponim i romanit të S. Beckett-it botuar në janar të vitit 1951 në Paris, nuk resht së foluri. "*Le silence de Molloy*" ("Heshtja e Molloit") është titulli paradoksal i artikullit entuziast që Bataille-i i kushtoi romanit në maj të të njëjtit vit, duke qenë kështu një nga lexuesit e parë, dhe më të thellë, të Beckett-it.

është heshtja (e aq më pak ta qepim, apo të mbyllim gojën), por të arrijmë të shohim vërtetësinë tronditëse të heshtjes, të arrijmë ta shohim gjuhën e artikuluar si mohimin e dhunshëm të dhunës ku vetëm heshtja mund të mbretërojë. Në të njëjtën kohë pothuaj me Bataille-in, një tjetër *pervertues* i hegelianizmit, Wittgenstein-i, lëshonte në faqen e fundit të *Tractatus logico-philosophicus*, një urdhëresë të ngjashme mbi detyrimin ndaj heshtjes. Nuk ka as metagjuhë e as metaligjërim. As gjuha e as logjika, me mjetet e tyre, nuk i rrokin dot themelet e tyre si të para nga jashtë. Kushti, dhe ndoshta vërtetësia mbeten pa fjalë, përtej shprehjes, objekte të mundshme të një aperceptimi mistik, të cilin fjalët e tepërta, fjalët "llafazane" e turbullojnë. Aforizmi i fundit (teksti është i 1918-ës) i *Tractatus*-it : "7 – Atë që nuk arrijmë ta themi (si duhet), duhet ta heshtim". Shumë fjalë e fjali (po aq sa gjeste, veprimtari, institucione...) e largojnë dhe e ruajnë njeriun nga ballafaqimi me vërtetësinë e vet të padurueshme. "Intelekti i përditshëm, i zënë me aradhën e qenësorëve, nuk arrin ta shohë botën si të tillë" – thotë Heideggeri. Gjuha shpesh i prish punë syrit dhe fjala turbullon vizionin, mundësia e vetme, e brishtë, e shpalosjes së vërtetësisë së qenies. Dhe ndodh që Bataille (p.sh. këtu, te *Hyrja*) të shohë te heshtja gjendjen e detyruar për të arritur vendosjen e një raporti autentik me qenien. Shkatërrimi i metafizikës (dhe vdekja e Zotit) është kështu bashkudhëtar i një farë shkatërrimi të gjuhës, në emër të kthjelltësisë së një shikimi të duruar dhe paradoksal, ku syri i perënduar, si në kulmin e epshit, i kthyer nga brendësia e zgavrës, qëndron njëkohësisht i ngulur mbi vërtetësinë e teprishme të qenies.

Bibliografi e shkurtër

- G. BATAILLE, *Histori e Syrit*, bot. Zenit, Tiranë, 2005.
 G. BATAILLE, *Letërsia dhe e Keqja*, përkth. shqip, bot. Zenit, Tiranë, 2007.
 Revista *Critique*, numër special, *Hommage à Georges Bataille*, n° 195-196, gusht-shtator 1963 (bot. Minuit, Paris).
 J.P. SARTRE, "Un nouveau mystique", në *Critiques littéraires. Situations I*, bot. Gallimard, Paris 1947.
 J. DERRIDA, "De l'économie restreinte, à l'économie généralisée. Un hégelianisme sans réserves", në *L'Écriture et la différence*, bot. Seuil, Paris 1967.
 J. HABERMAS, "Entre érotisme et économie générale : Bataille", në *Le Discours philosophique de la modernité*, përkth. fr., bot. Gallimard, Paris, 1988.